



BASHKIA SELENICE

BASHKIA SELENICE

Nr. 243/Prot.

Datë 10/08/2021

Njoftim për vende të lira pune për pranimin në nivelin bazë në shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin

Në zbatim të Ligjit nr.152/2015, datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” dhe VKM nr.520 datë 25.07.2019 Për miratimin e rregullores për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin Kreu i III “Ndarja e Funksioneve, nivelet, detyrat, procedurat e përzgjedhjes për emërim, lirim pezullim dhe përjashtim”, VKB nr.63 datë 19.12.2019 dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë së Selenicës për vitin 2020”, Urdhërit të Kryetarit Nr.80 date 28.12.2020 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së MZSH Bashkia Selenicë” Njësia e Burimeve Njerëzore në Bashkinë e Selenicës njofton se në Drejtorinë e MZSH-së shpallen:

I (Nje) vende të lira pune në pozicionet:

- Personel zjarrfikës, operues, luftues, 1 (Nje) pozicione (niveli bazë)

Përshkrimi i përgjithshëm i vendit të punës

Shërbimi i MZSH-së është një strukturë e specializuar e gatishmërisë së përhershme, misioni i të cilës është inspektimi, parandalimi me masat e marra për mbrojtjen nga zjarri, ndërhyrja për shuarjen e zjarreve, shpëtimi i jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidenteve të ndryshme, fatkeqësi natyrore, si dhe në ato të shkatuara nga dora e njeriut. Luftuesi/ Shpëtuesi /Drejtuesi i automjeteve dhe Punonjësi në sallën operuese është personi i emëruar në strukturat e shërbimit të MZSH-së, i trajnuar profesionalisht për të ndërhyrë në shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin e jetës së njeriut, të gjësë së gjallë dhe pronës.

Duhet të njohë dhe të zbatojë orarin e veprimeve, të dijë pozicionin në shërbim dhe detyrat e tij funksionale, të jetë në çdo kohë në gadishmëri të lartë për të vepruar në zgjidhjen e situatave që ndodhin, të njohë dhe të zbatojë rregullat e brendshme në stacion dhe të sigurojë paprekshmërinë dhe abuzimin e mjediseve, teknikës, pajisjeve etj, të mbajë pastër të gjitha ambjentet që disponon stacioni, të jetë i sjellshëm në komunikim me qytetarët që kërkojnë ndihmë, me kolegët duke pasqyruar një figurë qytetare dhe humane.

Kërkesa të përgjithshme per pranime

1. Të jetë shtetas shqipëtar
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar
3. Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i/e aftë për të kryer detyra me rrezik të shtuar
4. Të mos jetë i përjashtuar nga shërbimi zjarrfikës, Policia e Shtetit apo nga institucione të tjera
5. Të ketë mbaruar arsimin e mesëm
6. Të mos jetë i/e dënuar me vendim të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale me dashje
7. Të jetë nën moshën 30 (tridhjetë) vjeç;
8. Të jetë i gjatë, jo më pak se 1.70
9. Të ketë përfunduar testimin fiziko-profesional dhe kursin përkatës pranë Akademisë së Sigurisë ose në qendra të trajnimit zjarrfikës

Dokumentacioni, Mënyra dhe Afati i Dorëzimit

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:
Protokoll-Arkiyës –Sektori Menaxhimit Burimeve Njerëzore, Bashkia Selenicë këto dokumenta:

1. Kërkesë me shkrim drejtuar institucionit të Bashkisë (sektorit të shërbimit të MZSH- së)
2. Fotokopje e ID (kartë identiteti);
3. Çertifikatë familjare;
4. Një kopje të jetëshkrimit(CV);
5. Një numër kontakti (e-mail) si dhe adresën e plotë të vendbanimit;

6. Diplomë të njësuar me origjinalin të arsimit të mesëm (minimalisht);
7. Listë notash të njësuar me origjinalin;
8. Raport mjeko-ligjor nga autoriteti kompetent, që vërteton “gjëndje të mirë shëndetsore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar”;
9. Referencë me karakteristika specifike nga punëdhënësi i fundit (nëse ka);
10. Vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, si dhe nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor;
11. Fotokopje të librezës së punës e njësuar me origjinalin (nëse ka);
12. Çertifikata, trajnime profesionale, në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin (nëse ka);
13. Formulari i aplikimit (plotësimi i të cilit bëhet pranë zyrës së menaxhimit të burimeve njerëzore, Bashkia Selenicë);

Dokumentat duhet të dorëzohen në sportelet e Sektorit të Informimit dhe Shërbimeve për Qytetarët në Bashkinë e Selenicës brenda datës 18.08.2021

Rezultatet për Fazën e Verifikimit Paraprak

Në përfundim të afatit të verifikimit paraprak, Bashkia Selenicë do të shpallë “në faqen e internetit të Bashkisë Selenicë dhe në stendat e informimit të publikut listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe kriteret e aplikimit, të kërkuara më sipër si dhe për datën, vendin dhe orën e zhvillimit të procedurave.

Kandidatët e skualifikuar kanë të drejtë të ankimohen pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Selenicë. Afati i ankimit është 2 (dy) ditë nga data e shpalljes së rezultateve të verifikimit

Fusha kryesore mbi të cilën bazohet konkurimi

- Ligjin nr.139, date 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- Ligji nr.152, datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.
- VKM nr. 520 dt 25.07.2019 “Për miratimin e rregullores për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri”.

Mënyra e Vlerësimit të Kandidatëve

Kandidatët që kualifikohen për të vazhduar procesin e pranimit në shërbimin e MZSH-së u nënshtrohen fazave të konkurrimit, sipas rendit të mëposhtëm:

- a) Testim me shkrim;
- b) Testim i aftësiye fizike;
- c) Intervistë me gojë;
- ç) Testimi psikologjik;
- d) Verifikim përfundimtar i aplikantit.

Procedura e konkurimit do të ndjekë këto faza:

- Testimi me shkrim, shërben për të vlerësuar nëse aplikanti zotëron njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për kryerjen e detyrave të punonjësit të shërbimit të MZSH-së. Aplikantët që kanë marrë 70% të pikëve të përcaktuara për testin me shkrim, do të njoftohen për të vazhduar procesin e testimit të aftësive fizike.
 - Testimi i aftësive fizike, teston aftësitë psiko-motore, ku përfshihen: shpejtësia, shkathtësia fizike, rezistenca, forca muskulare dhe koordinimi fizik, të domosdoshme për punën e punonjësit të shërbimit të MZSH-së. Aplikantët që kanë marrë mbi 60% të pikëve maksimale vazhdojnë procesin e testimit.
 - Intervista me gojë konsiston në testimin e aftësive të aplikantit për të komunikuar qartë, për të shprehur ide dhe koncepte, si dhe për të analizuar e për të marrë vendime.
 - Testimi psikologjik konsiston në vlerësimin e aftësive të kandidatit për të reaguar në mënyrën e duhur në kushtet e një stresi minimal;
- Rezultati i përgjithshëm i aplikantit përcaktohet si shumatore e rezultatit të testimit me shkrim 50% dhe rezultatit të intervistës me gojë 50%.

Kandidatët fitues do të renditen sipas pikëve të mara dhe përzgjedhja e kandidateve për tu emëruar do të fillojë nga kandidati fitues që ka marrë më shumë pikë.

Njësia e Burimeve Njerëzore në Bashkinë e Selenicës do të shpallë fituesit “në faqen e internetit të Bashkisë Selenicë dhe në standat e informimit të publikut. Kandidatët jo fitues kanë të drejtë të ankimohen pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Selenicë. Afati i ankimit është 5 ditë nga data e shpalljes së rezultateve të testimit.

Kryetari

P/Sektorin e Shërbimit të MZSH-së Selenicë

Shezade Mujaj



The stamp is circular and contains the following text: "REPUBLIKA E SHqipërisë" at the top, "BASHKIA SELENICË" on the right, "SEKTORI I SHËRBIMIT TË MZSH" at the bottom, and "SHËRBIMET E MZSH" on the left. In the center of the stamp is the coat of arms of the Republic of Albania.